2014

Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Buletini i Tregut të Punës

Ky buletin paraqet në mënyre analitike të dhënat statistikore për vitin 2014 lidhur me tregun e punës në përgjithësi si dhe me impaktin e aktiviteteve dhe politikave që ka zhvilluar Shërbimi Kombëtar i Punësimit gjatë kësaj periudhe.

Botimi përmban informacion rreth:
Të dhënave të përgjithshme për tregun e punës; punëkërkuesve të papunë të regjistruar; Programit pasiv të pagesës së papunësisë; Politikave aktive të tregut të punës si dhe burimeve njerëzore në sistemin e Sh.K.P-it për vitin 2013.

Këtë botim mund ta gjeni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SH.K.P-it, ose pranë Drejtorive Rajonale të Punësimit, si dhe ne website http://www.kerkojpune.gov.al

Shërbimi Kombëtar i Punësimit
Bulevardi B. Curri
Pranë ish Hotel Arbana

Tel. +355 4 4538801
Mail. kontakt@shkp.gov.al

Metodologjia dhe definicionet

Popullsia në moshe punë: Popullsia në moshë punë i referohet popullsisë 15-64 vjeç.
Të dhënat mbi popullsinë në moshë pune sigurohen nëpërmjet Censusit të Popullsisë të realizuar nga INSTAT. Instituti i Statistikave, realizoi Censusin e Popullsisë dhe Banesave në Republikën e Shqipërisë gjatë muajit Tetor 2011, duke patur si koncept bazë "momentin e censusit" që përkon mesnatën e datës 30 Shtator dhe 1 Tetor 2011.

Forca e punës: Popullsia ekonomikisht aktive (forca e punës) përcaktohet si shumë e numrit të personave të punësuar me numrin e personave të papunë. Të dhënat mbi forcën e punës deri në vitin 2007 ishin vetëm të dhëna administrative, ndërsa pas këtij viti ato siguroheshin nga Anketa e Forcave të Punës në Shqipëri e kryer nga INSTAT që nga viti 2007 me periodicitet vjetor. Ndërsa në vitin 2013, periodiciteti i anketës ka qenë 3 mujor. Anketa zhvillohet pranë familjeve ku si njësi vrojtimi janë të gjithë personat 15 vjeç e lart në familje.
Mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga Anketa për Forcën e Punës bëhet një vlerësim sasior dhe dinamik i zhvillimeve të tregut të punës, përcaktohet pjesëmarrja në tregun e punës e personave në moshë 15 vjeç e lart, niveli i punësimit, punësimi sipas aktiviteteve ekonomike, punësimi sipas gjinisë dhe grupmoshave, shkalla e papunësisë, pjesëmarrja e grave në tregun e punës etj.
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.

Punësimi: Të punësuar janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë edhe për një orë kundrejt një page, ose përfitimi gjatë javës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës.
Leje lindjeje, sëmundje, lëndim apo paaftësi e përkohshme që presin të kthehen në punë; në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale;

- Të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët:

a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal
b) personi merr 50% ose më shumë të pagës;

- Të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale;
- Punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak.
- Punëtoret pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak.

Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

Aktualisht në Shqipëri, dy janë burime kryesore të dhënave të punësimit: Anketa e Forcave të Punës dhe Burimet Administrative.

Papunësia: Burimet e informacionit për papunësinë në Shqipëri janë: të dhënat administrative (ku papunësisë i referohemi si papunësi e regjistruar) dhe Anketa e Forcave të Punës.
Sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Punës (ILO) dhe të EUROSTAT-it, të papunë konsiderohen personat që në javën e referencës plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- nuk kanë punuar gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë nga e cila munguan përkohësisht);
-ishin të gatshëm për të punuar nëse do të gjenin një punë brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës;
-kanë kërkuar punë në mënyrë aktive gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës.

Shkalla e papunësisë është një nga treguesit më të njohur të tregut të punës i cili tregon përqindjen e personave të papunë ndaj popullsisë ekonomikisht aktive.

Popullsia ekonomikisht jo-aktive: Përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtëpiakë, në shërbim të detyrueshëm ushtarak, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

Shkurtimet e përdorura:

M.M.S&R - Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

SH.K.P - Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Z.P - Zyra Punësimi

D.R.F.P.P - Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik

Pu.Pa - Punëkërkues të Papunë

Përmbajtja:

Hyrje: Tregu i punës 2014..... 8

Kreu i parë: Papunësia e regjistruar.....15

Kreu i dytë: Politikat Pasive te tregut te punës 31

Kreu i tretë: Politikat aktive të tregut të punës 35

- Shërbime punësimi
- Programet e nxitjes së punësimit
- Programi i formimit profesional

Kreu i katërt: Shërbime ndaj punëdhënësve.....54

Kreu i pestë: Burimet njerëzore në sistemin e SH.K.P-it.....59

Tregu i Punës viti 2014

Karakteristika te përgjithshme: Gjatë vitit 2014 sipas vlerësimeve të marra nga Anketa e Forcave të Punës rezulton se për popullsinë ne moshe pune 15-64 vjeç:

- Pjesëmarrja ne Forcën e punës është 63.4%
- Shkalla e punësimit është 52,3 %.
- Shkalla e papunësisë është 17.4%
- Popullsia inaktive 36.6%

Fig.1: Treguesit kryesore te tregut te punës 2013/2014



Fig.2: Treguesit kryesore te tregut te punes sipas gjinise 2013/2014



Forca e punës

Për popullsinë 15-64 vjeç, forca e punës ishte 1.262.643 persona, ku 63.4% e saj janë aktive ne tregun e punës, dmth e punësuar ose ne kërkim aktiv te një pune (74,2% për meshkujt dhe 53,0% për femrat, 45,1 % për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç).

Tab.1: Forca e Punës me 3 mujore për periudhën 2013-2014

Forca e punës	Tr.1 2013	Tr.2 2013	Tr.3 2013	Tr.4 2013	Tr.1 2014	Tr.2 2014	Tr.3 2014
15-64 vjeç	**1,230,466**	**1,184,946**	**1,164,071**	**1,153,656**	**1,149,968**	**1,222,394**	**1,262,643**
15-29 vjeç	281,778	273,109	262,806	275,640	268,622	288,351	314,614
30-64 vjeç	948,688	911,838	901,265	878,015	881,347	934,044	948,029

Fig.3: Pjesëmarrja ne forcën e punës sipas gjinisë dhe grupmoshës.



Gjate 2014, krahasuar me te njëjtën periudhe te vitit 2013, vihet re një rritje e pjesëmarrjes ne forcën e punës me 4.8%, ndërsa krahasuar me tremujorin pararendës, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është rritur me 2,1 pikë përqindje. Ky tregues është rritur si për femrat ashtu dhe për meshkujt përkatësisht me 2,9 pikë përqindje dhe 1 pikë përqindje.

Punësimi

Numri i të punësuarve te moshe 15-64 vjeç në Shqipëri ishte 1.043.058 persona, ndërsa shkalla e punësimit ishte 52.3%..

Tab.2 Punësimi me 3 mujore për periudhën 2013-2014

Të punësuar	Tr.1. 2013	Tr.2. 2013	Tr.3. 2013	Tr.4. 2013	Tr.1. 2014	Tr.2. 2014	Tr.3. 2014
(15-64 vjeç)	**1,047,756**	**990,438**	**964,213**	**956,707**	**935,600**	**1,006,307**	**1,043,058**
15-29 vjeç	210,177	196,839	190,942	197,588	187,522	191,845	212,786
30-64 vjeç	837,579	793,599	773,271	759,119	748,078	814,462	830,272

Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2013 shkalla e punësimit është rritur me 3,7 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2014, shkalla e punësimit është rritur me 1,8 pikë përqindje. Gjatë tremujorit të tretë 2014, totali i të punësuarve është rritur 8,18 % krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2013

Fig 4: Struktura e punësimit sipas sektorëve ekonomik.



Ritmi i rritjes së punësimit sipas sektorëve nga tremujori i dytë në tremujorin e tretë 2014 është: 7,8 % në industrinë përpunuese; 6,2 % në ndërtim; 2,3 % në bujqësi.

Gjatë tremujorit të tretë 2014, pesha që zënë në punësimin total të punësuarit me pagë është 42 %. Të vetëpunësuarit (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë me pagë) përbëjnë 26,2 % të të punësuarve në tërësi, ndërsa punëtorët pa pagesë të familjes përbëjnë 31,8 % të punësimit total.

Fig.5: Shkalla e punësimit sipas statusit në punësim dhe nivelit arsimor ne % ndaj totalit.



Shkalla e punësimit (grupmosha 15-64 vjeç) është më e lartë për të punësuarit me arsim të lartë (65,7 %), pasuar nga ata me arsim të mesëm profesional (65 %). Të dhënat tregojnë se përqindja e të punësuarve me pagë është më e lartë për personat me arsim të lartë, dhe e kundërta vërehet tek të punësuarit me arsim 8/9 vjeçar ku mbizotërojnë punëtorët pa pagesë të familjes. Po të analizojmë të punësuarit me arsim të mesëm, shkalla e punësimit është më e lartë për personat me arsim të mesëm profesional krahasuar me personat që kanë kryer shkollën e mesme të përgjithshme, përkatësisht 65 % dhe 46,4 %. Një në pesë të punësuar të grupmoshës 15-64 vjeç me arsim 8/9 vjeçar janë të punësuar me pagë, afërsisht gjysma janë punëtorë pa pagesë të familjes, dhe një e treta e tyre janë të vetëpunësuar. Pesha që zënë të punësuarit me pagë rritet me rritjen e nivelit arsimor. Nga të punësuarit me arsim të lartë 87,7 % janë të punësuar me pagë dhe vetëm 4,6 % janë të punësuar si punëtorë pa pagesë të familjes. Tek të punësuarit me arsim të mesëm profesional dhe me arsim të mesëm të përgjithshëm përqindjet që zënë të punësuarit me pagë janë përkatësisht 46,7 % dhe 49,1 %.

Papunësia

Gjatë tremujorit të tretë 2014 në Shqipëri, numri i personave të moshës 15-64 vjeç që kërkojnë punë në mënyrë aktive është 219.585 persona. Shkalla e papunësisë për popullsinë 15-64 vjeç është 17,4 %.

Tab.3 Papunësia me 3 mujore për periudhën 2013-2014

Të punësuar	Tr.1. 2013	Tr.2. 2013	Tr.3. 2013	Tr.4. 2013	Tr.1. 2014	Tr.2. 2014	Tr.3. 2014
(15-64 vjeç)	**182,831**	**194,627**	**200,667**	**198,047**	**215,326**	**216,491**	**219,586**
15-29 vjeç	182,710	194,508	199,858	196,949	214,368	216,087	219,586
30-64 vjeç	71,601	76,270	71,864	78,053	81,099	96,505	101,828

Fig.6: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë.



Për grupmoshën 15-64 vjeç, shkalla e papunësisë mbetet më e lartë për meshkujt sesa për femrat, përkatësisht 19,6 % dhe 14,5 %. Krahasuar me tremujorin e dytë 2014, vihet re se shkalla e papunësisë si për meshkujt dhe për femrat ka pësuar një rënie të lehtë prej 0,2 pikë përqindje.

Shkalla e papunësisë për personat me arsim të mesëm të përgjithshëm është 24,3 % ose 6,9 pikë përqindje më e lartë se niveli mesatar kombëtar. Personat me arsim të lartë kanë një shkallë papunësie prej 18,1 %. Për personat me arsim të mesëm profesional dhe ato me arsim deri në 8/9 vjeçar shkalla e papunësisë është përkatësisht 13 % dhe 14 %.

Tab. 4: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grupmoshës

Mosha	Gjinia	Tr.1. 2013	Tr.2. 2013	Tr.3. 2013	Tr.4. 2013	Tr.1. 2014	Tr.2. 2014	Tr.3. 2014
15-64 vjeç	**Total**	**14.8**	**16.4**	**17.2**	**17.1**	**18.6**	**17.7**	**17.4**
	Meshkuj	16.0	18.6	19.8	18.9	19.9	19.8	19.6
	Femra	13.4	13.6	13.8	14.6	16.8	14.7	14.5
15-29 vjeç	**Total**	**25.4**	**27.9**	**27.3**	**28.3**	**30.2**	**33.5**	**32.4**
	Meshkuj	26.4	32.1	31.4	28.9	33.0	37.1	35.7
	Femra	24.0	21.6	21.2	27.4	25.4	27.1	26.9
30-64 vjeç	**Total**	**11.7**	**13.0**	**14.2**	**13.5**	**15.1**	**12.8**	**12.4**
	Meshkuj	12.7	14.2	16.1	15.5	15.5	13.8	13.6
	Femra	10.6	11.5	11.8	11.0	14.6	11.5	11.0

Gjatë tremujorit të tretë 2014 për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë është 32,4%. Krahasuar me tremujorin pararendës, shkalla e papunësisë për të rinjtë u ul me 1,1 pikë përqindje. Për popullsinë 30-64 vjeç në tremujorin e tretë 2014 shkalla e papunësisë është 12,4%.

Për sa i përket mënyrave të kërkimit për punë, 87,3 % e të papunëve u drejtohen të afërmve apo miqve/shokëve për të gjetur një punë. Kjo metodë e kërkimit për punë është e kombinuar dhe me aplikimin direkt tek një punëdhënës (52 %) si dhe me vendosjen e lajmërimeve në gazeta, studimin e lajmërimeve për vende të lira pune në gazeta etj. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, personat që po kërkonin punë për herë të parë përbënin 60,2 % të punëkërkuesve të papunë.

Popullsia ekonomikisht joaktive.

Gjatë tremujorit të tretë 2014 numri i personave të moshës 15-64 vjeç jashtë tregut të punës dhe që nuk po kërkojnë punë ose nuk janë të disponueshëm për të punuar (ndryshe popullsia ekonomikisht joaktive) është 730.137.

Tab.5: Popullsia ekonomikisht joaktive me 3 mujore për periudhën 2013-2014.

Popullsia ekonomish joaktive	Tr.1. 2013	Tr.2. 2013	Tr.3. 2013	Tr.4. 2013	Tr.1. 2014	Tr.2. 2014	Tr.3. 2014
(15-64 vjeç)	**754,547**	**800,057**	**820,756**	**831,344**	**837,217**	**770,343**	**730,137**
15-29 vjeç	417,313	439,409	437,678	434,874	458,405	408,616	382,339
30-64 vjeç	337,234	360,648	383,078	396,471	378,812	361,727	347,798

Popullsia e moshës 15-64 vjeç e klasifikuar si ekonomikisht jo-aktive përbën 36,6 % të popullsisë në moshë pune.

Tab.6: Popullsia ekonomikisht joaktive sipas strukturës së popullsisë.

Struktura e popullsisë ekonomikisht joaktive	2013	2014
Në arsim ose trajnim	39	36.6
Në pension	11.3	20.6
Beson që nuk ka punë të disponueshme	16.7	16.7
Në paaftësi të përhershme	5.7	5.7
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	17	17
Te tjerë	10.3	10.3

PUNEKERKUES TE PAPUNE TE REGJISTRUAR

Regjistrimi i të papunëve ne Zyrat e Punës bëhet në bazë të VKM Nr.70, datë 11.02.1999 "Për evidentimin e punëkërkuesve të papunë", ku sipas pikës 4 dhe 5 të këtij vendimi në Zyrat e Punësimit regjistrohet si i papunë çdo person në moshë, i cili paraqitet pranë zyrës së punësimit dhe *deklaron së nuk është në marrëdhënie punë; ose nuk është i vetë-punësuar, por gjithashtu është në kërkim të një pune.*

Sipas këtyre të dhënave, rezulton së në fund të 2014 të jenë të regjistruar pranë Zyrave të Punësimit 144.427 punëkërkues të papunë, ose 3085 vetë më pak së në fund te 2013.

Tab.7: Numri i Pu.Pa-ve në vite.

VITET	2010	2011	2012	2013	2014
Të Papunë të Regjistruar (në mijë)	**142.761**	**143.002**	**141.828**	**144.427**	**141.342**
Femra	72.900	73.754	73.014	74.551	71.710
Meshkuj	69.861	69.248	68.814	69.876	69.632

Duke iu referuar të dhënave të papunësisë së regjistruar për vitin 2014, konstatohet që dinamika e hyrje daljeve është gati dy here më e madhe së ajo e një viti më parë.

Tab.8: Bilanci vjetor i papunësisë së regjistruar.

Gjendje në fillim	hyrje				dalje				Gjendje në fund
	gjithsej	nga pagesa papunësisë	nga ndihma ekonomike	nga grupi të tjerë	gjithsej	nga pagesa papunësisë	nga ndihma ekonomike	nga grupi të tjerë	
144427	72364	8848	7045	56471	75449	8641	18900	47908	141342

Fig.7: Numri i Pu.Pa-ve në muaj 2014.



Ne rajonet Durrës, dhe Vlore kemi rritje te numrit te te papunëve qe ka rezultuar kryesisht ne sezonin e verës, ndërsa ne Lezhe Shkodër një rënie qe i përket me shume përfituesve te ndihmës ekonomike ne këto rajone.

Fig.8: Numri i Pu.Pa-ve sipas rajoneve 2013/2014



Sipas gjinisë. Në fund të 2014 rezultojnë të regjistruara si punëkërkuese të papuna 71.7 mijë pu.pa ferma, ose 51% e totalit të pu.pa-ve të regjistruar, shifër kjo pak a shumë e njëjtë me atë të një viti më parë.

Tab.9: Karakteristikat e Pu.Pa-ve femra në % ndaj totalit

Pu.Pa femra	Kryefamiljarë	Sipas grupmoshave								Sipas nivelit arsimor					
		deri 19 vjeç	20-24 vjeç	25-29 vjeç	30-34 vjeç	35-39 vjeç	40-44 vjeç	45-50 vjeç	mbi 50 vjeç	me pak së fillor	fillor	9 vjeçar	mesme përgj.	mesme prof.	universitar
100	11.1	4.3	11.0	11.7	11.9	12.5	13.1	16.6	19.0	2.7	9.8	41.5	27.6	10.7	7.7

Punëkërkueset e papuna femra janë kryesisht te moshave mbi 40 vjeç dhe me arsim deri ne 9 vjeçar. Pjesa më e madhe e familjeve me femra kryefamiljare kanë nivel të lartë varfërie dhe trajtohen kryesisht me ndihmë ekonomike.

Fig.9: Femra kryefamiljare sipas grupeve te papunesise.



Në rajonet Fier dhe Tiranë ka më shumë femra të papuna se sa meshkuj.

Fig.10: Pu.pa femra /meshkuj sipas rajoneve.



Sipas grupeve të papunësisë. Pu.pa të regjistruar pranë Zyrave të Punësimit si përfitues ose jo nga skemat e mbështetjes me të ardhura i ndajmë në 3 grupe.

- Pu.pa përfitues nga programi pasiv i pagesës së papunësisë
- Pu.pa anëtare të familjeve në ndihmë ekonomike
- Pu.pa të tjerë që nuk përfitojnë nga skemat e mbështetjes me të ardhura

.

Fig. 11: Ecuria e papunësisë së regjistruar në muaj sipas grupeve



Numri pu.pa-ve përfitues të skemës së pagesës së papunësisë ka shënuar luhatje gjate gjithë vitit. **Numri i Pu.pa-ve anëtarë të familjeve në ndihmë ekonomike ne moshe pune,** ketë vit ka shënuar një rënie te vazhdueshme**,** e cila ka ardhur si rezultat e rishikimit te kritereve te përfitimit për largimin nga skema te abuzuesve. Pavarësisht rënies se përfituesve nga kjo skeme në vitet e fundit, punësimi a ripunësimi i këtij grupi, për të gjitha Zyrat e Punësimit mbetet një problem serioz dhe i vazhdueshëm për arsyet si më poshtë:

- **grupmosha mbi 40 vjeç** (përbën 47% të totalit).
- **arsimi i ulët i tyre** (rreth 64% të tyre janë të nivelit arsimor deri në 9 vjeçar)
- **afatgjatësia** e qëndrimit të tyre në listat tona të papunësisë.
- "**Pasiviteti**" që karakterizon punëkërkuesit që vijnë nga skemat e ndihmës ekonomike.

Këta persona nuk kërkojnë punësim, por mbështetje me të ardhura, të cilat janë dhe arsyeja e paraqitjes së rregullt në çdo tremujor në zyrat tona. Ky pasivitet justifikohet dhe nga mungesa e transparencës së punësimit të tyre në mënyrë jo të rregullt në tregun jo formal të punës.

Duke përjashtuar rajonet Durrës, Fier, Gjirokastër dhe Vlore, ne te gjitha rajonet e tjera mbi 60% e te papunëve, te regjistruar pranë Zyrave te Punësimit, janë përfitues te skemave te mbështetjes me te ardhura.

Fig. 12: Pu.Pa qe mbështeten me te ardhura ne % ndaj totalit, sipas rajoneve.



Sipas nivelit arsimor. Vitet e arsimit të të papunëve janë klasifikuar në 6 nivele: më pak se fillor; fillor; 9 vjeçar; i mesëm i përgjithshëm; i mesëm profesional dhe universitar.

Struktura e papunësisë sipas nivelit arsimor të të papunëve të regjistruar tregon së përqindjen më të lartë e zënë punëkërkuesit me arsim 9 vjeçar, pasuar nga punëkërkuesit me arsim të mesëm.

Fig.13: Pu.pa të regjistruar sipas nivelit arsimor.



Krahasuar me fundin e 2013 kemi një rënie e 2% te pu.pa me arsim deri ne 9 vjeçar dhe një rritje me 2% të pu.pa me arsim universitar. Ky është targeti ku ka konsistuar dhe vazhdon te konsistojë promovimi i bërë shërbimeve që ofron institucioni ynë, duke qenë se kjo kategori është gati për tu futur në tregun e punës.

Sipas grupmoshave. Nga analiza e strukturës së papunësisë sipas grupmoshave, përqindja e të papunëve të regjistruar të grupmoshës 40 vjeç e lart është më e lartë. Ne 2014 kjo grupmoshe u rrit me 1% krahasuar me një vit me pare. Ndërsa përqindja e të papunëve të regjistruar të grupmoshës 25- 35 vjeç ka rënë me 2%. Kjo ka lidhje me kërkesat në rritje të tregut të punës për mosha relativisht të reja.

Fig.14: Pu.pa të regjistruar sipas grupmoshës .



Në qoftë se i referohemi aktiviteteve ekonomike që po punësojnë më shumë sot kemi: fasoni ku mosha mesatare e të punësuarve është 35 vjeç, kemi fushën e informacion komunikacionit (call center), ku mosha mesatare e punonjësve është 25-30 vjeç, turizmi dhe shërbimet ku mosha mesatare është 30-35 vjeç etj.

Grupet e veçanta të papunësisë: Kategorizimi i grupeve të veçanta është bërë me ligjin nr. 9570 dt 03.07.2006. Sipas ligjit të nxitjes së punësimit këto kategori kanë prioritet në përfshirjen në të gjitha politikat aktive shtetërore që zbaton institucioni ynë.

Tab.10: Pu.pa të regjistruar nga grupet e veçanta në vite.

Emërtimi	2010	2011	2012	2013	2014
mbështetur me të ardhura	66.7	64.0	64.0	57.0	54.7
afatgjatë	62.1	62.2	61.0	60.0	54.2
romë dhe egjiptian,	4.8	5.4	6.5	6.5	6.9
me aftësi të kufizuara	1.5	1.5	1.8	1.4	1.2
emigrantë të kthyer		0.3	0.7	1.4	1.6
jetimë		0.2	0.2	0.2	0.2

Tab.11: Pu.Pa sipas grupeve te veçanta dhe gjinisë.

Emërtimi	Pagesë papunësie	Ndihmë ekonomik	Afatgjatë	rome apo egjiptian	jetim	Aftësi të kufizuar	Emigrant ë të kthyer
gjithsej	7887	82349	87305	9439	218	1,972	2346
femra	49.2	50	50	50	55	42	31
meshkuj	50.8	50	50	50	45	58	69

Një pu.pa quhet afatgjatë, nëse ka mbi një vit që kërkon punë i regjistruar pranë Zyrës përkatëse të Punësimit. Përqindja që zënë të papunët afatgjatë ndaj totalit të të papunëve të regjistruar, është një nga treguesit e rëndësishëm të tregut të punës. Për vitin 2000, të papunët afatgjatë përbënin 89.6 % të totalit të të papunëve të regjistruar, ndërsa në vitet më pas deri në vitin 2011 kjo përqindje ulet deri në 62.3 % ndërsa në 2014 është ulur në 54.2% të totalit.

Fig.15: Pu.pa të regjistruar afatgjatë sipas periudhës së afatgjatësisë dhe rajoneve.



Siç shihet edhe në grafikun e mësipërm rrethet ku afatgjatesia ne papunësi është me e madhe janë rajonet Tirane, Elbasan, Korçë, Lezhe dhe Shkodër.

Duke iu referuar karakteristikave te pu.pa afatgjate, vihet re qe arsyet e afatgjatesise ne papunësi janë niveli i ulet arsimor, mosha e madhe si dhe gjinia (femrat kane me shume shanse te jene te papuna afatgjate se meshkujt). Theksojme qe 60% e te gjithë pu.pa kryefamiljare janë afatgjate.

Një kategori tjetër e rëndësishme është kategoria e romeve. Për këtë kategori është hartuar dhe "Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom", sipas të cilës institucioni ynë monitoron përfshirjen e kësaj kategorie në politikat shtetërore të punësimit.

Krahasuar me një vit më parë vihet re një rritje e numrit të të papunëve romë (me 3%). Kjo rritje vihet re në rajonet e Tiranës, Elbasan dhe Lezhës.

Fig.16: Pu.pa të regjistruar rome sipas rajoneve.



Numri i pu.pa femra rome është pothuajse i njëjte me te meshkujve, qe tregon qe ata janë kryesisht familje ne ndihme ekonomike. Gjithashtu janë pothuajse të gjithë me arsim deri në 9 vjeçar dhe i përkasin të gjitha grupmoshave, **gjë që tregon që shkaku i papunësisë së tyre është mungesa e arsimit.**

Numri i pu.pa **me aftësi të kufizuar është** ka një rënie krahasuar me vitin e kaluar për shkak te shtimit te vëmendjes për nxitjen e punësimit nga kjo kategori. Ne 2014 rezultojnë te regjistruar si kërkues pune pranë Zyrave te Punësimit 1732 persona me aftësi te kufizuar, nga te cilët ne % ndaj totalit:

- Femra 42.6%
- Kryefamiljare 47%
- Mosha mbi 45 vjeç përben 38.6%
- Me arsim deri ne 9 vjeçar janë 69.5%

Arsyet kryesore te këtyre tregjeve te larte te papunësisë se tyre janë:

- Mungesës se aftësive te tyre profesionale ne përputhje me kërkesat e tregut te punës.
- Moszbatimi i Ligjit të Nxitjes së Punësimit nga punëdhënësit, (nenet 15, 16)
- Mungesa e Përshtatshmërisë së ambienteve dhe vendit të punës, tek pjesa më e madhe e subjekteve.
- Ndërgjegjësim i ulet i komunitetit (për të pranuar ose jo paaftësinë e të punësuarve)
- Pamundësia të ndërmjetësohej në subjekte të ndryshme për shkak të natyrës së vështirë të aktivitetit.

Emigrantë të kthyer është një tjetër kategori e veçantë, e cila erdhi në fokus të politikave të punësimit në vitin 2010, kur me përshkallëzimin e krizës ekonomike në botë, shumë shqiptare në emigrim filluan të kthehen në vendin e tyre. Në zbatim të planit të masave të Strategjisë për Rintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer, si pjesë e politikave kombëtare për migracionin janë ngritur në të gjitha Zyrat e Punësimit sportele të emigracionit, të cilat janë sportele këshillimi, informimi, ndërgjegjësimi mbi situatën e tregut të punës me qëllim rintegrimin dhe punësimin sa më të shpejtë të tyre.

Fig. 17: Numri i emigranteve te kthyer sipas vendeve te emigrimit dhe shkaqeve te kthimit.



Vihet re qe pavarësisht vendit ku kane qene emigrante karakteristikat e tyre janë te ngjashme. Te gjithë janë te moshave mbi 30 vjeç, me arsim te mesëm dhe te larte dhe shkaku kryesor i kthimit është papunësia.

Fig.18: Emigrante te kthyer sipas shërbimeve te kërkuara në % ndaj totalit.



Tab. 12: emigrante te kthyer sipas karakteristikave individuale dhe rajoneve.

Emertimi	TOTALI	BERAT	DIBER	DURRES	ELBASAN	FIER	GJIROKASTER	KORCE	KUKES	LEZHE	SHKODER	TIRANE	VLORE
Gjithsej	**2209**	**100**	**32**	**199**	**237**	**302**	**101**	**317**	**13**	**20**	**218**	**533**	**137**
femra	252	45	4	46	51	100	34	99	0	8	35	185	49
kryefamiljar	420	48	19	88	108	133	0	103	4	12	99	193	60
GRUPMOSHAT													
15 - 19	38	1	0	4	9	3	2	2	0	0	7	8	2
20 - 24	192	20	2	11	15	25	12	27	0	1	35	36	8
25 - 29	366	14	5	42	55	43	12	44	4	4	43	83	17
30 - 34	420	22	6	48	36	46	16	72	2	4	40	102	26
35 - 39	427	19	8	34	72	56	18	44	4	4	32	120	16
40 - 44	305	7	4	22	45	32	15	50	2	0	20	87	21
45 - 50	202	8	5	25	3	40	10	26	1	3	18	47	16
mbi 50	259	9	2	13	2	57	16	52	0	4	23	50	31
ARSIMI													
me pak se fillor	3	0	0	0	0	0	2	1	0	0	0	0	0
fillor	53	5	1	1	0	7	10	14	0	0	0	15	0
9 vjeçar	784	43	18	87	66	113	29	138	7	7	55	169	52
mesme pergj.	793	35	11	80	79	99	34	129	6	9	97	178	36
mesme prof.	428	12	1	17	87	69	16	27	0	4	42	113	40
universitare	148	5	1	14	5	14	10	8	0	0	24	58	9

Ndërsa si grupe të tjera të veçanta mund të përmendim **jetimët.** Kemi 173 të regjistruar si kërkues pune, nga të cilët 46% janë femra. Ata janë në rajonet Dibër, Fier, Lezhë dhe Shkodër, kanë mosha relativisht të reja (84% janë të rinj deri në 29 vjeç) por kanë nivel arsimor të ulët (64% me arsim deri në 9 vjeçar).

Pu.pa sipas grupeve të profesioneve. Një tjetër element shumë i rëndësishëm për përputhjen e kërkesës me ofertën është profesioni i pu.pa të regjistruar pranë Zyrave tona të Punësimit. Grupimi i pu.pa sipas profesioneve është bërë në bazë të grupeve dhe nëngrupeve kryesorë të kodit të profesioneve në fuqi.

Tab.13 Pu.pa sipas profesioneve dhe gjinisë.

Emërtimi	Menaxhere/Specialiste me arsim të larte	Teknike /specialiste të mesëm	Nëpunës	Punonjës të shitje/shërbimeve	Punonjës të kualifik. bujq. pyjeve peshkimit	Zejtare zanatçinj	Punonjës në industri	Profesione elementare	Forca t e armatosura
Gjithsej	8221	6019	3377	10336	6810	26359	8994	69865	1361
Femra	60.8	54.5	60.9	56.5	52.3	41.1	19.7	56.1	12
meshkuj	39.2	45.5	39.1	43.5	47.7	58.9	80.3	43.9	88

• **Pu.Pa menaxher dhe specialistë me arsim të lartë janë** vetëm 6% e totalit të pu.pa ose 2% me shume se nje vit me pare**.** Në qoftë se shikojmë brenda kësaj kategorie, vihet re se 33% e totalit janë pu.pa me profesion mësues, 17% ish-punonjës të administrim biznesit (kryesisht ekonomistë) dhe 20% ish-punonjës të fushës ligjore shoqërore dhe kulturore (kryesisht juristë, punonjës socialë) numri i te cilëve është shtuar gjate 2014.

Fig.19: Specialistë me arsim të lartë sipas gjinisë.



• **Teknikë dhe specialistë të mesëm janë** 4.3 % e totalit të pu.pa. Ndërsa me profesione 27% janë ekonomistë të mesëm, 22% specialistë të mesëm të shëndetësisë, 18% teknikë të mesëm të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit. Vihet re një rritje e numrit të pu.pa-ve me profesion bashkëpunëtore profesioniste në inxhinieri dhe shkence në 18%.

Fig.20: Pu.Pa teknike te mesem sipas gjinise.



• **Nëpunës janë** punonjës të arkave, agjentë shitblerje dhe nëpunës të informimit të klientit, të cilët përbëjnë vetëm 2.4% të totalit të pu.pa të regjistruar. Ndersa **Punonjës të shitjes dhe të shërbimeve,** është një grup profesionesh me shumë dinamikë hyrje daljesh në tregun e punës. Ata përbejnë 7.3% të totalit të të regjistruarve ose 1% me shume se nje vit me pare, qe jane me shume meshkuj te regjistruar ne profesionet e bar restoranteve. Kërkesat në rritje për ketë grup, sidomos për aftësi shtesë ne komunikim si dhe ne përdorim te kompjuterit dhe gjuhëve te huaja, e bëjnë më të vështirë punësimin e tyre.

Fig.21: Pu.Pa nëpunës dhe punonjës të shitjes dhe të shërbimeve sipas gjinisë.



• **Punonjës të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit,** janë kontingjenti i ardhur kryesisht nga ish-fermat dhe kooperativat bujqësore dhe kanë mosha relativisht të mëdha. Këto i përkasin rajoneve të zonave veri-lindore si Dibra, Puka si dhe zona fushore të njohura për prodhime bujqësore si rrethi i Lushnjës. Numri i pu.pa nga kjo kategori përben 5% të totalit, por që është në rënie nga viti në vit. Vetëm për 2014 kjo shifër ka renën me 3%.

• **Zejtar dhe zanatçinj,** është grupi më dinamik për sa i përket hyrjeve dhe daljeve në tregun e punës**.** Sot ato përbëjnë 18.6% të totalit të të regjistruarve, shifër kjo në te njëjtat nivele me vitin e kaluar. Pu.Pa nga ky grup, te ardhur nga aktiviteti i ndërtimit janë 36.7% dhe 29.2% janë të degëve të industrisë përpunuese (kryesisht fasonit), i cili karakterizohet nga luhatjet në punësim.

Fig.22: Pu.Pa zejtar dhe zanatçinjë sipas gjinisë.



• **Punonjësit në industri përbëjnë 6.4% të totalit,** ne rritje nga viti i kaluar me 1%. Duke i pare nga nënkategoritë kemi 46% janë punonjës të makinerive industriale, prej të cilëve një pjesë janë ish-punonjës të fabrikave dhe uzinave që janë mbyllur dhe një pjesë e punonjësve të ndërmarrjeve me fason që hyjnë dhe dalin si kërkues pune në bazë të kontratave që këto ndërmarrje lidhin. Pjesa më e madhe e kësaj kategorie 80.3% janë meshkuj, pasi femrat janë punësuar në ndërmarrjet e fasonit.

Fig.23: Pu.Pa punonjes te industrise sipas gjinise.



• **Me profesione elementare 49.4% ose 1.3% me pak se një vit më parë.** Ky është kontingjenti më i madh i kërkuesve të punës të regjistruar në Zyrat e Punësimit, të cilët janë kryesisht pjesëtarë të familjeve që mbështeten me të ardhura nga shteti. Pu.pa nga ky kontingjent janë kryesisht afatgjatë (pjesa më e madhe mbi 3 vjet), me arsim deri në 9 vjeçar, i përkasin të gjitha grup-moshave, por më dominuesja është ajo mbi 40 vjeç.

Fig.24: Pu.Pa me profesione elementare sipas gjinise.



Pjesa tjetër janë ish-punonjës të forcave të armatosura kryesisht oficer dhe nënoficer të dalë në reformë

Fig. 25: Pu.pa të regjistruar sipas profesioneve dhe rajoneve.



Për tu njohur me problematikën e punësimit që shfaqin profesionet e ultë, të cilët mbartin pu.pa sipas rajoneve, shikojmë grafikun e mësipërm. Vëmë re që pu.pa me profesione elementarë përbëjnë mbi 30% të totalit të pu.pa të regjistruar për të gjitha rajonet, por kjo shifër kalon mbi 50% në rajonet Durrës, Elbasan 70%, Kukës Lezhë dhe Shkodër me 60%. Ndërsa zanatçinj ka më shumë në rajonet industriale si Berati, Durrësi, Fieri, Korça, Lezha dhe Vlora.

Ndërsa nëse i shikojmë problemet e fuqisë punëtore nga këndvështrimi i bizneseve po iu referohemi gjetjeve kryesore të **anketës së nevojave për aftësi (SNA), i cili është studimi i radhës i realizuar nga SH.K.P-it në bashkëpunim me Projektin IPA të BE për vitin 2014.**

- *Mungesa e Kulturës se Punës dhe Kualifikimi i Papërshtatshëm i fuqisë punëtore* janë dy nga shqetësimet madhore të bizneseve, të shprehura përkatësisht nga 39.8% dhe 33.0% e numrit total të bizneseve. Kultura e punës arrin nivelin maksimal të shqetësimit në sektorin e *Shërbimeve Administrative dhe atyre Mbështetëse.* Niveli i papërshtatshëm i kualifikimit të forcës së punës përbën një shqetësim për pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë, por ai përbën një shqetësim edhe më të madh për sektorët e *Minierave, Energjisë, Gazit, etc.* si edhe atë *Pasurive të Patundshme.* Ky shqetësim është më i pranishëm në kompanitë e mesme dhe të mëdha.
- Humbja e aftësive profesionale si rezultat i papunësisë afatgjatë përbën një shqetësim relativisht të madh për sektorët e *Energjisë, Gazit, etj.* dhe *Pasurive të Patundshme*, ndërsa pagat e ulëta duket se përbëjnë një shqetësim të vërtetë për sektorin e *Furnizimit me Ujë, Kanalizimet dhe Mbetjet.*
- Sipas rajoneve, pothuajse të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Rajonin Jugor pranojnë se kanë të paktën një shqetësim madhor në lidhje me punësimin, por incidenca është më e ulët në Rajonin Qendror dhe, madje edhe më e ulët në Rajonin Verior. Shqetësimi në lidhje me *Kulturën e Punës* shfaqet në një shkallë më të lartë në biznese në Rajonet Qendrore dhe Jugore dhe në një shkallë më të ulët në Rajonin Verior. *Barra e lartë fiskale përsa i përket punësimit* duket se përbën një shqetësim për një pjesë të madhe të bizneseve në Rajonin Jugor. Shqetësimi në lidhje me *pagat e ulëta* në Jug është 3 herë më i lartë sesa në Rajonin Qendror.

- Shumica e bizneseve që kanë shqetësimin në lidhje me *"kualifikimin e papërshtatshëm të forcës së punës"* dhe me *"kulturën e punës"* janë biznese në pronësi të të huajve dhe sipërmarrje të përbashkëta.
- Disa biznese nuk janë të kënaqur me aftësitë e punonjësve të tyre ekzistues. Rreth 15% e bizneseve deklarojnë se punonjësit e tyre ekzistues nuk i kishin aftësitë e duhura. Profesionet ku vërehet mospërputhja e aftësive janë kamerierët, punëtorët e ndërtimit dhe shitësit e dyqaneve. Më shumë se 95% e bareve & restoranteve, që përfaqësojnë rreth 10% të bizneseve të vogla në Shqipëri, kanë pritshmëri më të mëdha përsa i përket aftësive të kamerierëve dhe/ose banakierëve të tyre. Mungesa e aftësive përkatëse tek punonjësit aktualë duket relativisht shumë e lartë për sektorët e *Furnizimit me Ujë, Kanalizimeve, Mbetjeve* si edhe për sektorët e *Minierave e Guroreve.*
- Bizneset e vogla deklarojnë se kanë punonjës që nuk i kanë aftësitë e duhura dhe kjo lidhet më shumë me kamerierët dhe banakierët. Bizneset e pakënaqura të cilët punësojnë kamerierë kanë të punësuar 63% të forcës së punës mashkullore. Numri më i madh i bizneseve të pakënaqura me aftësitë e punonjësve gjendet në Rajonin Jugor.
- Përsa i përket Rajoneve, ai Jugor ka shkallën më të lartë të bizneseve të pakënaqura me aftësitë e punonjësve të tyre. Në Rajonin Verior, mangësitë janë më të lidhura me profesionet në industritë prodhuese, të minierave dhe asaj të ndërtimit. Në Rajonin Qendror janë të lidhura më shumë me profesione në sektorin e shërbimeve, ndërsa në Rajonin Jugor pakënaqësitë lidhen më shumë me profesione të sektorëve të shërbimeve dhe ndërtimit.
- Personave që punojnë si kamerierë, banakierë, kuzhinierë dhe recepsionistë, në shumicën e rasteve, ju mungojnë "aftësitë e komunikimit" ndërsa shitësve në 50% të rasteve ju mungon "aftësia për të punuar në ekip". Punëtorët e ndërtimit dhe të zanateve të lidhura me të (duke përjashtuar elektricistët) prej 86% të rasteve nuk kanë "përvojë të mjaftueshme pune". Kjo përforcon përfundimin logjik se megjithëse arsyet janë shumë të ndërlidhura me njëra tjetrën, shkaku kryesor është "*Njohuri të pamjaftueshme që në kohën e rekrutimit"*, që do të thotë në fakt se kjo është ajo çka mund të gjesh në tregun e punës.
- Përsa i përket sektorëve, mungesa e aftësive të duhura tek punonjësit aktualë duket relativisht e lartë për sektorët e *Furnizimit me Ujë, Kanalizimet, Mbetjet, si dhe Minierat e Guroret,* dhe kjo përfaqëson përkatësisht 41.9% dhe 40.2% të kompanive.

PROGRAMI PASIV I PAGESES SE PAPUNESISE.

Programi i pagesës së papunësisë është pjesë e politikave shtetërore të punësimit, të cilat sigurojnë mbështetjen me të ardhura të të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës. Ky program vazhdon të mbetet një nga programet me të rëndësishme që zbatohet nga Zyrat e Punësimit edhe pse këtë vit rezultojnë të jenë përfshirë në ketë skemë rreth 7800 vetë.

Fig. 26: Pu.pa të regjistruar, përfitues nga skema e pagesës se papunesise.



Siç shikohet edhe nga grafiku i mësipërm, numri i pu.pa-ve përfitues nga skema e pagesës së papunësisë në vite ka ardhur në rënie. Në 2014 është shënuar numri më i vogël i përfituesve në 15 vitet e fundit.

Tab.14 Pu.pa në pagesë papunësie sipas gjinisë.

Emërtimi	2010	2011	2012	2013	2014
Pu. Pa në pagesë papunësie	9265	9367	8861	7887	7734
femra (numër fizik)	51	50	49	49	47
meshkuj	49	50	51	51	53

Raporti femra meshkuj në këtë program varet nga specifikat e degës së ekonomisë që paraqet vështirësi në periudhën që nxjerr të papunë. Në 2009–2010 në kuadrin e krizës ekonomike botërore ndërmarrjet e fasonit kishin luhatje në kontrata dhe për rrjedhojë herë pas here shkurtonin vendet e punës. Duke ditur që rreth 80% e punonjësve të këtyre bizneseve janë femra kjo solli dominancë të femrave në programin e pagesës së papunësisë. Ndërsa në dy vitet e fundit kemi ndërtimin në rënie dhe industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës në

ristrukturim, si pasojë është rritur numri i meshkujve përfitues nga programi i pagesës së papunësisë.

Për të parë problematikat e këtij grupi për sa i përket punësueshmerisë, shikojmë karakteristikat e përfituesve si statusin, moshën dhe gjininë.

Fig.27: Pu.Pa të regjistruar në pagesë papunësie sipas grupmoshës dhe nivelit arsimor.





Kjo na tregon që njerëzit me të rrezikuar për të humbur vendin e punës janë mosha mbi 40 vjeç, dhe me arsim të detyrueshëm.

Fig.28: Pu.Pa të regjistruar në pagesë papunësie sipas rajoneve dhe gjinisë.



Tab.15: Bilanci vjetor i skemës së pagesës së papunësisë.

Shtesat për muajin									pakësime për muajin							
Gjithsej					arsyet e papunësisë				Gjithsej					arsyet e largimit		
gjithsej	shtet	privat	Pagese e zakonshme	vendime veçanta	nga reformat	nga zvogëlim aktiviteti te ndërmarrjes	ristrukturim ose privatizim i ndërmarrjes	arsye te tjera	gjithsej	shtet	privat	Pagese e zakonshme	vendime veçanta	punësuar	mbarojnë afatin	te tjera
9303	4066	5237	9207	96	2268	4606	1094	1335	9456	3016	6440	8865	591	1083	7829	544

Vëmë re që në skemën e programit të pagesës së papunësisë gjatë gjithë vitit kanë hyre 9303 vetë ose mesatarisht 775 vetë në muaj, fluks ky i njëjte me te një viti me pare. Hyrjet më të mëdha i përkasin muajve Janar dhe Dhjetor dhe 56% e tyre kanë ardhur nga sektori privat.

Fig.29: Hyrjet e përfituesve te programit te pagesës se papunësisë sipas sektorëve.



Sipas arsyeve të humbjes së vendit të punës, 50% e tyre janë të papunë nga zvogëlimi i aktivitetit të ndërmarrjeve ku kanë punuar, 24% nga reformat në këto ndërmarrje (shifër kjo dyfish me shume se një vit me pare) dhe 12% si rezultat i ristrukturimeve dhe privatizimeve, pjesa tjetër janë arsye të tjera.

Fig.30: Hyrjet e përfituesve te programit te pagesës se papunësisë sipas arsyeve te humbjes se vendit te punës.



Ndërsa daljet vjetore shkojnë në shifrën e 8865 pu.pa nga të cilët vetëm 300 pu.pa vazhdojnë të jenë të regjistruar në Zyrat e Punësimit ndërsa pjesa tjetër janë larguar pas përfundimit të përfitimit. Vetëm 12% e totalit të daljeve janë largime për arsye punësimi.

Fig.31: Daljet e përfituesve te programit te pagesës se papunësisë sipas arsyeve te humbjes se përfitimit.



POLITIKAT AKTIVE TE TREGUT TE PUNES

Ashtu si shumica e vendeve evropiane, që nga viti 1999 Shqipëria zbaton një sërë politikash aktive për të "korrigjuar" defektet e tregut të punës që sjellin papunësi. M.M.S.R është hartuese e këtyre politikave dhe nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit një shërbim publik, autonom, me statusin e një administrate shtetërore qendrore, i zbaton ato për të gjithë punëkërkuesit e papunë që kërkojnë punë nëpërmjet Zyrave të Punësimit.

SHERBIME PUNESIMI: Qëllimi i shërbimeve të punësimit është të ndihmojë punëkërkuesit për tu integruar në tregun e punës dhe punëdhënësit për të plotësuar vendet e lira të punës, të ofruara prej tij .

Objektivat e shërbimeve publike të punësimit janë :

a) të informojnë
b) të këshillojnë
c) të orientojnë
d) të ndërmjetësojnë punëkërkues të papunë për vendet e lira të punës të ofruara nga punëdhënësit **Rezultati final i shërbimeve të punësimit është ndërmjetësimi për punë, pra përputhja e kërkesës me ofertën.**

Oferta për pune: Për vitin 2014, kemi rreth 30 583 oferta për punë të shpallura në Zyrat e Punësimit, gati dyfishin e ofertave te një vit më parë.

Fig.32: Ofertat e punës sipas mënyrës se sigurimit dhe llojit te saj.





Vëmë re rritje te vendeve te lira te deklaruara nga punëdhënësi si dhe trefishim te vendeve te reja te punës krahasuar me një vit me pare.

Për të parë së në cilat rajone ka konsistuar zhvillimi ekonomik në këtë vit, shikojmë në grafikun e mëposhtëm ofertat e reja sipas rajoneve në raport me totalin.

Fig.33: Ofertat për pune sipas rajoneve ne % ndaj totalit për rajon.



Fig.34: Ofertat për punë sipas aktiviteteve ekonomike.



Vihet re një rritje e vendeve të lira të shpallura në shërbime me 3% si ndërsa ofertat në degën e informacion komunikacionit janë rritur me 6% krahasuar me vitin e kaluar. Ndërsa në rënie paraqiten ofertat e industrisë përpunuese me 2% dhe ndërtimit po me 5% dhe tregtia me 3%.

Fig.35: Ofertat për punë sipas kategorive profesionale.



Krahasuar me 2013 kemi një rritje te kërkesës për zanatçinj me 1%, për teknik dhe specialiste te mesëm me 6% ndërsa kemi rënie për kërkesat për grupet e tjera te profesioneve. Kërkesa për specialiste te larte është ne te njëjtat nivele me një vit me pare.

Fig.36: Ofertat sipas llojit dhe kategorive profesionale.



Fig.37: Raporti i plotësimit të vendeve të lira në vite ndaj totalit.



Për të parë së cilat oferta kanë qenë më të vështira për tu plotësuar shikojmë nivelin e plotësimit të ofertave sipas kategorive profesionale dhe rajoneve.

Fig.38: Raporti i plotësimit të vendeve të lira sipas kategorive profesionale dhe rajoneve.



Ofertat me nivelin më të ulët të plotësimit janë teknikë të mesëm (37%), nëpunës (44%) dhe (37%) specialist të lartë. Kjo vjen si rezultat i arsimit të ulët që kanë pu.pa e regjistruar pranë Zyrave tona të Punësimit (mbi 50% me arsim deri në 9 vjeçar) dhe mungesës së një profesioni (rreth 50% me profesione elementare).

Për të ilustruar konkluzionin e mësipërm shikojmë grafiket e mposhtëm.

Fig.39: Raporti i pu.pa dhe ofertave të punës në % ndaj totalit sipas kategorive profesionale.



Fig.40: Numri i pu.pa dhe ofertave të punës sipas rajoneve.



Pu.Pa te punësuar: Gjatë 2014 janë punësuar 16490 pu.pa ose 30% me shume se një vit me pare ku 54.6% janë femra.

Fig.41: Pu.Pa te punësuar sipas gjinisë 2013/2014



Siç shikohet nga fig 33 kemi me shume femra te punësuara ne raport me meshkujt ne te gjitha rajonet por diferenca është me i madh ne Tirane Durrës Fier dhe Shkodër.

Tab.16: Pu.Pa te punësuar femra dhe kryefamiljare ne % ndaj totalit.

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Gjithsej	10964	14277	10261	12611	11907	12317	12748	12965	12241	16490
Femra ne % ndaj totalit	49.0	53.0	41.0	43.0	45.0	51.5	48.3	55.0	50.1	54.6
Kryefamiljare ne % ndaj totalit	27.0	26.0	30.0	25.0	26.0	24.3	22.1	23.0	24.4	20.8

Nga të punësuarit 17% të të totalit janë punëkërkues afatgjatë, ndërkohe qe nga totali i pu.pa te regjistruar 54% janë afatgjate. Kjo tregon vështirësitë qe ka punësimi nga ky grup te cilat rriten me rritjen e afatgjatesise se tyre ne papunësi. Nga ana tjetër mundësitë e punësimit nga ky grup janë te ndryshme ne rajone te ndryshme.

Ne Fig.34 jepet niveli i punësimit nga grupi afatgjate (qe është 17% për totalin) me nivelin e papunësisë se këtij grupi (qe është 54% për totalin) e pare sipas rajoneve për te theksuar se ku është me shume kjo vështirësi.

Fig.42: Pu.Pa te punësuar afatgjate sipas kohezgjatjes ne papunësi, dhe rajoneve.



Pu.pa afatgjate janë punësuar kryesisht ne degët e industrisë përpunuese (57%), ne ndërtim (10%) dhe tegeti e shërbime (15%).

Punësimet janë realizuar më tepër me punëkërkuesit e grupit "të tjerë" rreth 87.6% dhe 12.4% janë nga skemat e mbështetjes me të ardhura**.**

Fig.43: Pu.Pa te punësuar nga skemat e mbështetjes me te ardhura sipas rajoneve.



Po ti referohemi karakteristikave të pu.pa të punësuar, 46% e tyre i përkasin **grupmoshës deri në 29 vjeç, ose 3% më shume se një vit më parë** , pastaj vjen duke u ulur punësimi për grupmoshat e tjera. Për sa i përket nivelit arsimor të punësuarve mund të themi se, 35 % e tyre janë me arsim deri në 9 vjeçar, 47 % me arsim të mesëm e profesional dhe **18% janë me arsim të lartë.**

Nga totali i Pu.Pa te punësuar 223 janë te kategorisë rome apo egjiptian te moshës 20-30 vjeç dhe me arsim deri ne 9 vjeçar. Këta janë kryesisht femra te punësuara ne industrinë përpunuese ne profesionet e punëtoreve te makinerive.

Ndërsa emigrante te kthyer janë punësuar 217 vete kryesisht te moshës 20-40 vjeç dhe me arsim te mesëm e te larte. Ata janë punësuar kryesisht ne call center dhe shërbime.

Fig.44: Pu.pa të punësuar sipas karakteristikave të përgjithshme.



Nga totali i punësimeve në shkallë vendi, peshën më të madhe e zëne Rajonet :

- Durrës me 3259 ose 19.8% të totalit
- Tiranë me 3250 punësime ose 19.7% të totalit,
- Fier me 2055 punësime ose 12.5.%,
- Vlorë me 1877 ose 11.4 % e totalit,

PROGRAMET E NXITJES SE PUNESIMIT.

Programet e nxitjes së punësimit janë disa nga programet aktive shtetërore të cilat veprojnë drejtpërsëdrejti në grupin e punëkërkuesve të papunë për t'i nxitur ata në gjetjen e një punësimi sa më afatgjatë. Programet e nxitjes së punësimit kanë filluar të zbatohen që vitin 1999 dhe kanë për qëllim nxitjen e punësimit apo ripunësimit të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet formimit në punë, suvensionimit për punësim, nxitjes së vetëpunësimit, hapjes së vendeve të reja të punës, praktikave profesionale. Këto programe, së bashku me programin e ndërmjetësimit në punë, ndikojnë realisht në uljen e numrit të të papunëve të regjistruar dhe ajo që është më e rëndësishme mbetet largimi i tyre nga skemat pasive të mbështetjes me të ardhura (pagesa e papunësisë dhe ndihma ekonomike).

Fig.45: Fondi I Nxitjes se Punesimit ne vite.



Për vitin 2014 Fondi në i vënë në dispozicion për këtë program ka qenë 270 milion lekë ose 3 fish i fondit te 2013. Sipas programeve janë zbatuar projektet si më poshtë:

Nëpërmjet VKM Nr. 47, "Për programin e punësimit, nëpërmjet formimit në punë", janë trajtuar 51 subjekte të cilat kanë formuar nëpërmjet punës 1071 punëkërkues të papunë.

Fig.46: Subjektet përfituese te programeve sipas VKM 47



Tab.17: Pu.Pa përfitues sipas VKM 47.

Emertimi	gjithsej	femra	kryefamiljare	te rinj deri ne 29 vjeç	arsim deri ne 9 vjeçar	nga skemat e mbështetjes me te ardhura	afatgjate	rome	aftësi te kufizuar	emigrante te kthyer	viktima te trafikut
V.K.M 47	1071	744	125	562	596	23	173	41	5	9	3

Në këtë program përfshihen kryesisht te rinj pa arsim dhe profesion, ndaj mosha më dominuese e pu.pa-ve pjesëmarrës është deri në 35 vjeç dhe niveli arsimor dominues është deri në 9 vjet.

Nëpërmjet VKM Nr. 48, "Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të pu.pa në vështirësi", janë trajtuar 172 subjekte të cilat kanë punësuar 2221 punëkërkues të papunë në vështirësi për një kohëzgjatje 12 muaj, duke qene keshtu programi me i preferuar për vitin 2014.

Fig.47: Subjektet përfituese te programeve sipas VKM 48.



Tab.18: Pu.Pa përfitues sipas VKM 48.

Emërtimi	gjithsej	femra	kryefamiljare	te rinj deri ne 29 vjeç	mbi 40 vjeç	arsim deri ne 9 vjeçar	nga skemat e mbështetjes me te ardhura	afatgjate	rome	aftësi te kufizuar	emigrante te kthyer	jetime
V.K.M 48	2221	1424	410	944	700	1190	248	801	106	4	11	4

Ne këtë program**,** përfshihen kryesisht pu.pa nga kategoritë e disavantazhuara ne tregun e punës, për punësimin e te cilëve shteti suvensionon ndërmarrjen, ndaj pjesamrresit janë kryesisht te rinj, moshat e mëdha, pu.pa me arsim te ulet, përfitues nga skemat e mbështetjes me te ardhura, afatgjate, rome etj.

Nëpërmjet VKM Nr. 873, ”Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë”, janë trajtuar 426 punëkërkues të papunë (studentë të diplomuar 24 muajt e fundit), të cilët kanë zhvilluar praktikat në 97 subjekte. Nëpërmjet aplikimit të programit të praktikave profesionale për studentët e sapodiplomuar, mundësohet përfitimi i eksperiencës së duhur për një punësim sa më afatgjatë.

Fig.48: Subjektet përfituse te programeve sipas VKM 48.



Tab.19: Pu.Pa përfitues sipas VKM 873.

Emërtimi	gjithsej	femra	te rinj deri ne 29 vjeç	arsim universitar	nga skemat e mbështetjes me te ardhura	afatgjate	rome	aftësi te kufizuar
V.K.M 48	426	302	413	426	14	67	1	1

Nëpërmjet VKM Nr. 27, "Për nxitjen e punësimit të punëkërkueseve të papuna femra", janë zbatuar 12 programe (10 nga te cilat janë zbatuar ne degët e industrisë përpunuese) ku janë punësuar 120 prej tyre.

Tab.20: Pu.Pa përfitues sipas VKM 27.

Emërtimi	gjithsej	te rinj deri ne 29 vjeç	30-40 vjeç	arsim deri ne 9 vjeçar	arsim te mesme	arsim universitar	nga skemat e mbështetjes me te ardhura	afatgjate
V.K.M 48	120	58	55	49	55	16	13	45

Nëpërmjet VKM Nr. 199, "Për nxitjen e punësimit të punëkërkuesve të papune te rinje", janë zbatuar 21 programe ku janë punësuar 117 prej tyre.

Fig.49: Subjektet përfitues te programeve sipas VKM 199.



Gjate 2014 u zbatua për here te pare një program specifik për personat me aftësi te kufizuar i cili u pilotua ne rajonet Tirane dhe Elbasan. Subjektet e përfshira kane qene kryesisht te aktiviteteve profesionale financiare, administrative, publike. Nga ky program përfituan 14 pu.pa nga kjo kategori, te gjithë femra kryesisht moshave 20-35 vjeç dhe me arsim te mesëm dhe te larte.

Përveç programeve te financuara nga buxheti i shtetit gjate 20147 kemi dhe **programe të nxitjes se punësimit të financuara nga PNUD** në 29 subjekte ku janë përfshirë 222 pu.pa të regjistruar pranë Zyrave të Punësimit. Pjesa me e madhe e këtyre programeve (24 prej tyre) janë zbatuar ne

subjekte qe zhvillojnë aktivitetin e tyre ne degët e industrisë përpunuese dhe 5 te tjera ne shërbime. Përfituesit e këtyre programeve kane qene kryesisht femra (82% e totalit) te moshave deri ne 29 vjeç (91% e totalit), te arsimit 9 vjeçar (60%). Ata janë zbatuar ne rajonet Kukës Lezhe dhe Shkodër.

Fig.50: Të dhëna për programet e nxitjes sipas VKM-ve dhe rajoneve.



Rajonet e Gjirokastrës dhe Tiranes kane patur numrin me te larte te subjekteve përfituese, ndërsa numrin me te larte te pu.pa përfitues e kane patur rajonet Tirane dhe Durrësit.

Fig.51: Pu.Pa nga grupet e veçanta pjesëmarrës ne program sipas rajoneve.



Si përmbledhje për programet e zbatuara gjate vitit 2014 mund te themi:

- ju është dhënë prioritet kategorive specifike e grupeve të veçanta dhe në vështirësi si, personat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës të moshës 18-25 vjeç, të papunët afatgjatë, romët, personat me aftësi të kufizuar si dhe ata të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie. Këto grupe përbëjnë rreth 40% të totalit të punëkërkuesve të papunë përfitues nga këto programe.
- fushat prioritare kanë qenë industria përpunuese (33% e totalit) shërbimet (20% e totalit) ndërtimi (8.5%e totalit) dhe tregtia (8% e totalit).
- Kemi patur programe te zbatuara ne te gjitha rajonet. VKM 48 është me e zbatuara ne te gjitha rajonet duke përjashtuar Tiranen dhe Fierin qe kane patur ne përparësi dhe VKM 47 gjithashtu.

PROGRAMI I FORMIMIT PROFESIONAL.

Një nga detyrat themelore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit është formimin dhe riformimin profesional për punëkërkuesit e papunë. Shteti ofron mbështetje financiare për të gjithë punëkërkuesit e papunë që pranojnë të ndjekin kurset e trajnimit që u ofrohen në 10 Qendrat Publike të Formimit Profesional, të cilat ndodhen në qytetet më të mëdha të vendit si Vlorë, Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Gjirokastër, Fier dhe një qendër e lëvizshme për zonën Verilindore.

Fig. 52: Fondi i programit të formimit profesional në vite



Ndërsa numri i të trajnuarve në vite jepet si më poshtë. Në vitin 1998 kanë qenë vetëm 6 Q.F. P. Publike, në 2009 u hap dhe Q.F.P. Publike Vlorë, në vitin 2005 Q.F.P. Publike Fier dhe në 2008 një qendër e lëvizshme për zonën Verilindore të vendit.

Fig. 53: Numri i te Trajnuarve ne QFP Publike në vite.



Fig.54: Te trajnuar ne vite sipas Q.F.P-ve Publike.



Për vitin 2014, janë regjistruar 13893 persona, nga të cilët 45% jane femra dhe ne fund te kursit janë **certifikuar 13102 prej tyre.** Kurset kanë një kohëzgjatje 2-6 muaj.

Tab.21: Te dhena per kurset e formimit profesional ne QFP Publike qe kane perfunduar ne 2014.

emërtimi I QFP Publike	kurse	te regjistruar	punëkërkues te papune									te punësuar	te burgosur	te tjerë	te certifikuar
			gjithsej	femra	tarife falas										
					gjithsej	romet	femrat e trafikuara	ish te burgosur	jetimet	me aftesi te kufizuar	emigrante te kthyer				
QFP NR.1	189	**2884**	1386	481	1386	12	0	2	6	11	71	198	34	604	**2640**
QFP NR.4	200	**2323**	1637	658	1637	69	9	1	2	6	20	112	251	220	**2269**
QFP DURRES	153	**1885**	897	391	897	3	0	0	0	0	6	45	304	5	**1869**
QFP FIER	57	**785**	660	249	660	36	0	39	0	0	9	31	60	34	**665**
QFP VLORE	108	**1325**	615	336	615	0	7	0	1	0	15	105	248	183	**1196**
QFP GJIROKASTER	49	**448**	203	77	203	0	0	0	0	0	5	40	22	116	**441**
QFP ELBASAN	291	**2015**	1299	586	1299	9	0	1	1	213	10	200	0	36	**1967**
QFP KORÇE	67	**890**	432	229	432	4	11	0	0	3	12	181	20	164	**813**
QFP SHKODER	94	**1061**	717	253	717	42	0	1	2	6	22	100	0	91	**979**
QENDRA LEVIZESE	21	**277**	252	98	252	0	0	0	0	11	0	15	0	1	**263**
totali	1229	**13893**	8098	3358	8098	175	27	44	12	250	170	1027	939	1454	**13102**

Kurset ne QFP-te Publike frekuentohen njesoj nga te gjitha grupmoshat, dallojne vetem llojet e kurseve qe ndjekin. Niveli arsimor i shumices se te trajnuarve eshte i mesem.

Fig.55: Karakteristikat individuale te trajnuarve.





Duke filluar nga muaji janar 2014, të gjithë punkërkuesit e papunë kanë mundësi të kryejnë kurse profesionale falas në të gjithë Qëndrat Publike të Formimit Profesional. Kjo ka sjelle dyfishimin e numrit te punekerkuesve te papune ne 10691 persona qe ndjekin keto nderkohe qe 8098 prej tyre i kasne perfunduar ato dhe te tjeret jane ne proces.

Fig. 56: Te trajnuarit sipas statusit.



Pjesamrrja e te papuneve ne trajnim ka qene ne te gjitha vitet ne shifrat 40%-55%. Per here te pare ne 2014 kjo shifer shkoi ne 75%. Sipas QFP-ve kjo shifer varion 60%-95%.

Fig.57: Niveli i pjesëmarrjes ne trajnim sipas statusit ne % ndaj totalit.



Ndërsa për sa i përket zbatimit të marrëveshjes nr.1366 të Korrikut të 2009 midis Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, për ofrimin e kurseve të formimit profesional në IEVP-të, mund të themi që është marrëveshja e cituar më sipër ka patur një zbatim shumë të mirë pothuajse në të gjitha rajonet në këto 5 vite.

Sipas shtrirjes gjeografike: Në 2009, u zhvilluan kurset e para në IEVP e Vlorës për anglisht, kompjuter, kuzhinë dhe hidraulik. Në 2010 përvoja në IEVP Vlorë u shtri edhe në IEVP-të e tjera si në Tiranë, Durrës, Fier, Gjirokastër, por qe kurset ishin kryesisht për gjuhë të huaja dhe

përdorim kompjuteri. Në 2011 fillon të shtohet llojshmëria e kurseve sidomos për profesione, në të njëjtën kohë u përfshinë në kurse edhe femrat e burgosura. Në 2012 në burgun e femrave në Tiranë janë shtuar kurset si qëndistari, rrobaqepësi, kujdestar fëmijësh.

Fig.58: Te burgosur te trajnuar sipas QFP-ve dhe viteve.



- **Sipas kurseve:** Ka patur një dominancë për kurset e gjuhëve të huaja si anglisht, italisht, përdorim kompjuteri dhe një kërkesë më e ulët për kurset e profesioneve.

Fig.59: Te burgosur te trajnuar sipas llojit te kurseve.



Pu.pa te punësuar: Janë punësuar mbas kryerjes së kurseve 454 persona ose vetëm 5% te te trajnuarve ne kurset e profesioneve. Nga pu.pa e punësuar pas formimit 275 femra. Punësimet janë realizuar kryesisht në aktivitete si rrobaqepësi, parukeri estetike, kuzhine, menaxhim ndërmarrjesh hidraulik, etj.

Fig.60: Pu.pa te punësuar sipas profesionit te marre ne trajnim.



SHERBIME NDAJ PUNEDHENESVE.

Një tjetër klient shumë i rëndësishëm i Zyrave të Punësimit janë dhe punëdhënësit. Shërbimet që në ofrojmë ndaj tyre janë si më poshtë:

- Shërbime profesionale rekrutimi të fuqisë punëtore, plotësim të vendeve të lira të punës.
- Mbështetje për punësim (programe aktive)
- Informacion mbi tregun e punës dhe legjislacionin në fuqi etj.

Tab.22 Kontaktet me punëdhënësit sipas mënyrës së kontaktimit

Emërtimi	2012	2013	2014
Kontakte me punëdhënësit	43691	45224	51542
a) në zyrën e punësimit për:	30147	33009	37626
- Deklarim punësimi	28315	31478	32768
- Deklarim i vendit të lire të punës	1832	1531	4858
b) në ndërmarrje:	13544	12215	13916
- Vizita të reja	3517	2695	3267
- Vizita të përsëritura	10027	9520	10649

Nga kontaktet me punëdhënësin janë marrë 26788 oferta pune ose 60% me shume se nje vit me pare, nga të cilat 52% nga vizitat në ndërmarrje të bëra nga specialistët e shërbimeve.

Fig.61: Numri i kontakteve me punëdhënësin dhe vendet e lira te marra, sipas rajoneve.



Rajonet me produktivitetin më të lartë të vizitave në ndërmarrje për sa i përket finalizimit me marrjen e vendit të lirë, janë Berati, Durrësi, Fier, Korça dhe Vlora.

Ndërsa për sa i përket deklarimeve të punëdhënësve, vetëm 31% e totalit të subjekteve të regjistruara në Zyrat e Tatim Taksave në rrethe, kanë ardhur në Zyrat e Punësimit për deklarimin e punësimit apo të vendit të lirë. Nëse flasim për pronësinë e ndërmarrjeve të deklaruara kjo shifër shkon 50% për shtetin dhe 30% për privatin. Ndërmarrjet me deklarimin më të ulët janë personat fizikë dhe VIPA-t. Ndërmarrjet me deklarimin më të lartë janë subjektet juridike vendase.

Rajonet me nivelin më të lartë të deklarimit janë rajonet e vogla si Dibër, Kukës dhe Lezhë, me mbi 80% të subjekteve, ndërsa rajonet me nivelin më të ulët të deklarimit janë rajonet Tiranë, Durrës dhe Berat.

Niveli i kontratave kolektive të lidhura nga ndërmarrjet është shume i ulet. Vetëm 1% e subjekteve të regjistruara në Zyrat e Tatim Taksave në rrethe kane depozituar pranë Zyrave të Punësimit një kontrate kolektive, shifër kjo qe për ndërmarrjet shtetërore shkon 10% ndërsa për privatet në 1%. Kemi vetëm 757 kontrata kolektive te depozituara te cilat mbulojnë 55030 punonjës.

Fig.62: Numri i kontratave dhe punonjësit e përfshire ne to sipas sindikatave.



Sic shikohet nga Fig.54, K.S.SH dhe B.S.P.SH jane sindikatat me me peshe ne vend jo vetem nga numri I kontratave te lidhura por edhe per numrin e punonjesve te perfshire ne to.

Në lidhje me plotësimin e vendeve të lira të punës të shpallura nga punëdhënësit, mund të themi që edhe pse numri i tyre në krahasim me vitin e kaluar është dyfishuar, përqindja e plotësimit të tyre për vitin 2014 është në masën 54%.Pjesa tjetër janë në proces, janë anudhuar nga punëdhënësi apo janë refuzuar nga kandidati.

Fig.63: Ofertat e punës të paplotesuara sipas arsyeve.



Aktivitetet ekonomike ku janë refuzuar më së shumti ofertat janë degët e industrisë përpunuese (kryesisht ndërmarrjet e fasonit) dhe call center. Gjithashtu edhe për realizimin e punësimeve ne këto dege, Zyrat e Punësimit hasin vështirësi te mëdha. Niveli i plotësimit te ofertave është me i ulet se ne aktivitetet e tjera (ne industrinë përpunuese është 51% ndërsa ne call center është vetëm 24%).

Fig.64: Niveli i plotësimit te vendeve te lira sipas aktiviteteve ekonomike.



Një tjetër shërbim i rëndësishëm që ne ofrojmë ndaj punëdhënësve është dhënia e lejeve të punës për të huajt.

Gjatë vitit 2014 janë dhënë rreth 2054 leje pune, ose 120 më pak se një vit më parë.

Fig.65: Lejet e punës për të huaj sipas viteve.



Për të parë se ku kanë konsistuar këto leje për sa i përket statusit të të huajve që ka përfituar leje pune, dhe shtetësi shohim tab.16.

Tab.23 Lejet e punës për te huajt në vite.

Emërtimi	2011	2012	2013	2014
gjithsej	2300	2499	2189	2054
-punëmarrës	93%	88%	87%	89%
-investitor	0.1%	1%	1%	2%
-te vetëpunësuar	6.9%	11%	12%	9%

Investitorët janë 9 te huaj ne aktivitetet miniera tegeti transport dhe shëndetësi, me shume greke dhe turq te cilët i zhvillojnë aktivitetet ne rajonet Tirane , Vlore dhe Pogradec.

Te vetpunësuarit jane 183 te huaj kryesisht ne tegeti, shërbime shëndetësi, janë kryesisht shtetas turq, kinez, kosovare, maqedonas, pakistanez dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre pjesa me e madhe ne rajonin e Tiranes dhe pastaj ne Durrës, Elbasan Fier dhe Lezhe.

Punëmarrës janë 1847, pra pothuajse te gjithë te huajt qe pajisen me leje pune. Ata janë te punësuar kryesisht ne ndërtim, miniere, industri përpunuese dhe shërbime dhe ne rajonet ku janë përqendruar investimet e huaja ne këto dege.

Fig.66: Të huajt të pajisur me leje pune sipas aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes.



Ndërsa për sa i përket shtetësisë, në 2009 dominonin shtetasit kinezë në fushën e tregtisë, në 2010 shtetasit turq pajisur me leje pune u shtuan duke zënë 35% të totalit të lejeve kryesisht të punësuar në fushën e ndërtimit. Në 2012 shtetasit turqit zënë vetëm 19% të totalit, por shikojmë shtimin e shtetasve grekë dhe atyre italianë me 15% të totalit kryesisht në degët e industrisë përpunuese. Në 2013 kemi shtetas kanadezë më shumë se një vit më parë të punësuar në industrinë e naftës, shtetas kosovarë në fushën e shërbimeve si dhe turq kryesisht në ndërtimin e veprave industriale kryesisht hidrocentraleve.

Fig.67: Lejet e punës sipas shtetësisë.



BURIMET NJEREZORE NE SISTEMIN E SHEBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT.

Performanca e tregut të punës është e lidhur ngushtësisht me performancën e stafit të sistemit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit si dhe menaxhimin e buxhetit vjetor të tij.

Tab.24: Fondi i SH.K.P-se sipas programeve në vite

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
pagese papunësie	909	1040	868.5	870.6	868.2	981.8	875.9	1000	860	846
nxitje	134	120	119.2	212.3	181.7	133.2	129.5	90	90	270.6
formim profesional	**72**	**74**	**97.3**	**116.1**	**124.3**	**128.7**	**98**	109	**138.5**	**200**
administrate	209	205	270	310.9	304	289.4	300.6	308	305.8	370
investime	84	74	76.3	113.4	48.7	38.6	16.9	23	5.9	26.4
total	**1408**	**1513**	**1431.3**	**1623.3**	**1526.9**	**1571.7**	**1420.9**	**1530**	**1400**	**1713**

Siç shikohet në grafikun e mëposhtëm fondi me i madh i Sh.K.P shkon për programin pasiv të pagesës se papunësisë edhe pse në vitet e fundit ka patur rënie. Fondi për programin e nxitjes se punësimit ketë vit është 3 fish, ndërsa për programin e formimit profesional fondi në 2014 ka patur një rritje të konsiderueshme prej 40%. Fondi i investimeve në infrastrukture dhe pajisje është rritur me 4 here.

Fig.68: Fondi i SH.K.P-se sipas programeve.



Tab.25: Stafi i SHKP-it sipas kategorisë profesionale.

kategoritë	numri i punonjësve		zyrat e punësimit		qendrat e formimit profesional		drejtoria qendrore	
	gjithsej	femra	gjithsej	femra	gjithsej	femra	gjithsej	femra
drejtues	93	42	51	23	13	4	6	2
Specialistë me arsim të lartë	329	219	228	167	79	49	27	21
teknikëdhe specialistë në zbatim	16	11	3	2	10	8	0	0
nëpunës të thjeshtë	13	6	3	0	2	1	2	1
punëtore	13	7	4	2	6	4	3	1
TOTALI	**437**	**285**	**289**	**194**	**110**	**66**	**38**	**25**

Fig.69: Stafi i SHKP-se sipas gjinisë.



Edhe pse shpërndarja e personelit nëpër Zyrat e Punësimit është bërë pak a shumë në bazë të numrit të pu.pa që trajton çdo Zyre dhe numrit të subjekteve të cilëve ju shërben, përsëri themi që stafi është i pamjaftueshëm në plotësimin e standardeve të ngarkesës për specialist. Zyrat e Punësimit Shkodër, Tiranë dhe Elbasan kanë mungesa të theksuara të personelit duke patur parasysh këto kritere.

Fig.60: Shperndarja e personelit te ZP sipas rretheve



Për sa i përket arsimit 95% e të gjithë stafit janë me arsim të lartë, me një pagë mujore mbi 40 mijë lekë të reja.